



QKSS

Qendra Kosovare për Shërbime të Elitit



**PROGRAMI
KËRCËNIMET
E REJA**

PERSPEKTIVA RAJONALE: SI QËNDROJNË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR NË MBROJTJEN E INFRASTRUKTURËS KRITIKE?



Dhjetor 2023

Mbështetur nga:



**SMART
Balkans**
Civil Society for Shared Society
in the Western Balkans



Autor: Jon Limaj

Rreth Programit Kërcënimet e Reja

Programi Kërcënimet e Reja (The Emerging Threats Programme) është projektuar si një përgjigje ndaj kërcënimeve në rritje të sigurisë vendore, rajonale dhe ndërkombëtare. Qëllimi i tij kryesor është të konsolidojë dhe të ofrojë një kuptim më të mirë të kërcënimeve në zhvillim që vazhdimisht largohen nga konceptualizimi tradicional i sfidave të sigurisë. Duke pasur parasysh shtrirjen e kërcënimeve në zhvillim që lidhen me sigurinë kibernetike dhe dezinformimin, ky program synon të ndërtojë kapacitetet e brendshme organizative për të ofruar ekspertizë të bazuar në dëshmi për të funksionalizuar përgjigjet institucionale ndaj këtyre sfidave. Hulumtimi i bazuar në dëshmi në lidhje me Programin e Kërcënimeve të reja (The Emerging Threats Programme) fokusohet në: infrastrukturën kritike, sigurinë kibernetike, dezinformimin dhe sfidat hibride të sigurisë. Përderisa vlerësimi(et) e nevojave, monitorimi dhe hulumtimi mbeten veprime themelore për t'u zhvilluar në program, QKSS synon të shfrytëzojë ekspertizën e krijuar për të rritur drejtpërdrejt kapacitetet e institucioneve dhe agjencive ekzekutive për t'u përgjigjur në mënyrë efektive sfidave të sigurisë kibernetike dhe dezinformimit. Programi do të zhvillohet përmes:

- Hulumtimeve më të reja të bazuara në dëshmi në lidhje me kërcënimet në zhvillim si:iguria kibernetike, dezinformimi infrastruktura kritike, sulmet hibride etj;
- Fushatat për ngritjen e vetëdijes dhe avokim të synuar për të përmirësuar nivelin e të kuptuarit të sfidave që lidhen me sigurinë kibernetike, infrastruktura kritike, sulmet hibride etj, në Kosovë;
- Mbështetjen për ngritjen e kapaciteteve për institucionet dhe agjencitë ekzekutive për të zhvilluar mjete dhe strategji për të hartuar përgjigje ndaj kërcënimeve në zhvillim.

Për më shumë informacion, na kontaktoni në: EmergingThreats@qkss.org

Ky dokument i shkurtër i politikave është publikuar në kuadër të projektit SMART Balkans, i zbatuar së bashku nga Qendra për Promovimin e Shoqërisë Civile, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM), me mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë.

PERSPEKTIVA RAJONALE: SI QËNDROJNË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR NË MBROJTJEN E INFRASTRUKTURËS KRITIKE?

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	1
Çështjet kryesore	1
Hyrje në Infrastrukturën Kritike në Ballkanin Perëndimor dhe profilin e rrezikut rajonal	3
Llojet kryesore të Infrastrukturës Kritike në vendet e Ballkanit Perëndimor	5
Korniza e politikave të Mbrojtjes së Infrastrukturës Kritike (Strategjitë dhe Praktikët) në Ballkanin Perëndimor dhe përafrimi me BE-në	9
Sugjerime për qëndrueshmërinë e infrastrukturës kritike në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor	11
Referenca	12

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport trajton mjedisin e infrastrukturës kritike në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, përkatësisht: Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Bosnje dhe Hercegovinën, Serbinë dhe Kosovën. Raporti analizon dobësitë kryesore të rajonit në lidhje me mbrojtjen e infrastrukturës kritike, të formësuara nga faktorë të tillë si tensionet etnike, konfliktet historike, ndryshimet demografike dhe sfidat mjedisore.

Raporti identifikon llojet kryesore të infrastrukturës kritike thelbësore për zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin social të rajonit: energjinë, transportin, telekomunikacionin, ujin dhe kanalizimet, kujdesin shëndetësor dhe shërbimet emergjente. Megjithatë, nënvizon mungesën e mirëmbajtjes, masave mbrojtëse dhe koordinimit, duke e lënë infrastrukturën të hapur ndaj rreziqeve të mundshme.

Duke analizuar kornizën e politikave, nxjerr në pah ngjashmëritë midis Bashkimit Evropian (BE) dhe Ballkanit Perëndimor (BP). Në vijim të zhvillimit të strategjive të qëndrueshmërisë pas sulmeve të 11 shtatorit, BE-ja ka vendosur një fokus të fortë në garantimin e sigurisë së infrastrukturave kritike. Vendet e Ballkanit Perëndimor, në procesin e anëtarësimit në BE, kanë nënshkruar një Plan të Përbashkët Veprimi për Luftë Kundër Terrorizmit, duke u përfruar me standardet e BE-së. Pavarësisht

dallimeve në përkufizimin e infrastrukturës kritike në vendet e Ballkanit Perëndimor, po bëhen përpjekje në vazhdimësi për të krijuar sisteme efikase të mbrojtjes.

Analiza e ligjeve të shteteve përkatëse zbulon se katër vende të Ballkanit Perëndimor: Kosova, Shqipëria, Mali i Zi dhe Serbia, kanë miratuar ligje të veçanta për infrastrukturën kritike, derisa në Bosnje dhe Hercegovinë ekziston një ligj përkatës vetëm në nivel entiteti, por jo në nivel shtetëror. Në përgjithësi, ata po ndjekin trajektoren e BE-së për Mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike. Maqedonia e Veriut është në proces të hartimit të ligjit për Infrastrukturë Kritike. Duke vlerësuar progresin e bërë, raporti thekson nevojën për bashkëpunim të vazhdueshëm politik dhe profesional për të harmonizuar metodologjitë e mbrojtjes së Infrastrukturës Kritike në Ballkanin Perëndimor.

Analizat tregojnë se sa e rëndësishme është për shtetet e Ballkanit Perëndimor të mbrojnë infrastrukturën e tyre kritike. Përderisa Ballkani Perëndimor punon drejt anëtarësimit në BE, është thelbësore të vendosen sisteme të forta mbrojtjeje. Këto masa luajnë një rol kyç në nxitjen e rritjes ekonomike, ruajtjen e stabilitetit social dhe rritjen e qëndrueshmërisë së përgjithshme.

Çështjet kryesore:

1 Rreziqet rajonale:

Ballafaqimi me kërcënimet kibernetike në rritje, të ilustruara nga sulmet e fundit kibernetike ndaj institucioneve qeveritare dhe financiare.

2 Llojet e Infrastrukturës Kritike:

Energjia, transporti, telekomunikacioni, uji dhe kanalizimi, kujdesi shëndetësor dhe shërbimet e emergjencës, që janë jetike për zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin social.

3 Korniza e Politikave:

Nënshkrimi i Planit të Përbashkët Veprimi për Luftë Kundër Terrorizmit. Përkundër faktit se përkufizimet e Infrastrukturës Kritike ndryshojnë nga njëra tjetra, nevoja për bashkëpunim të vazhdueshëm është ende e evidente.

4 Analiza e ligjeve të shteteve përkatëse:

Katër vendet e Ballkanit Perëndimor kanë miratuar ligje specifike të Infrastrukturës Kritike, derisa Bosnja dhe Hercegovina zbaton ligjin për sigurinë e infrastrukturës kritike. Maqedonia e Veriut është në proces të hartimit të ligjit. Gjë që nënvizon kërkesën e vazhdueshme për bashkëpunim politik dhe profesional për të krijuar metodologji të standardizuara për ruajtjen e infrastrukturës kritike.

Hyrje në Infrastrukturën Kritike në Ballkanin Perëndimor dhe profilin e rrezikut rajonal

Sistemet e infrastrukturës kritike përfshijnë infrastrukturën e energjisë, sistemet e transportit, telekomunikacionin, sistemet e ujit dhe ujërave të zeza, objektet e kujdesit shëndetësor, shërbimet financiare, shërbimet e emergjencës, ushqimin dhe bujqësinë, objektet qeveritare dhe monumentet kombëtare. Këto sisteme janë vendimtare për shoqërinë sepse këto sisteme ofrojnë mbështetje jetike dhe shërbime thelbësore për zhvillimin ekonomik, sigurinë, përfshirjen dhe mirëqenien e qytetarëve tanë. Këto sisteme mbështeten tek njëra-tjetra dhe janë të ndërlydhura.

Ashtu si Kosova, edhe vendet tjera të Ballkanit Perëndimor si Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, dhe Serbia ballafaqohen njëjtë me rreziqet komplekse rajonale, si tensionet etnike, si dhe mosmarrëveshjet kufitare dhe mosmarrëveshje dypalëshe të tjera. Të gjitha këto vende janë demokraci në zhvillim dhe shumica e tyre ende nuk janë rikuperuar plotësisht nga pasojat e luftërave jugosllave në vitet 1990. Për shkak të ndryshimeve të fundit demografike si dhe ndryshimeve klimatike.

Ballkani Perëndimor është i cenueshëm nga fatkeqësitë natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu. Ndotja e lartë dhe degradimi i mjedisit, përmytjet, erozioni, tërmetet, siguria e digave, mungesa e ujit, sulmet kibernetike dhe kërcënimet terroriste janë disa nga shqetësimet kryesore të këtij rajoni. Për më tepër, duke qenë se ishte i vështirë rikuperimi nga pandemia e COVID-19, Ballkani Perëndimor në ditët e sotme po përballlet me sfida si rezultat i luftës në Ukrainë, si çmimet e larta të ushqimit dhe energjisë dhe normat e përgjithshme të larta të inflacionit në rajon.

Disa nga fatkeqësitë më të fundit në infrastrukturën kritike të Ballkanit Perëndimor

janë tërmeti i vitit 2019 në Shqipëri ku sektori i infrastrukturës kritike pësoi dëme dhe humbje të mëdha njerëzish; përmytjet e shpejta në Maqedoninë e Veriut në vitin 2016, ku pati edhe humbje njerëzish dhe dëmtime të mëdha në infrastrukturë kritike e gjithashtu humbje të mëdha nga përmytjet kanë pasur edhe Bosnja dhe Hercegovina në vitin 2014 dhe Serbia në 2014. Ky trend i ngjarjeve të fatkeqësive natyrore pritet të rritet më tej për shkak të ndikimit të ndryshimeve klimatike që shkaktojnë ngjarje ekstreme të motit në shumicën e zonave të rajonit të Ballkanit Perëndimor, veçanërisht situatat ekstreme të lidhura me thatësinë dhe nxehësinë. Ekzistojnë gjithashtu rreziqe dhe kërcënime të reja në rajon, si kriza e vazhdueshme e migrantëve dhe refugjatëve që rezultoi në shumicën e 1.4 milionë migrantëve dhe refugjatëve që arritën në BE, duke kaluar tranzit në Rrugën e Ballkanit Perëndimor.

Pati një seri sulmesh kibernetike ndaj institucioneve, uebfaqeve dhe portaleve qeveritare dhe financiare shqiptare gjatë verës dhe vjeshtës së vitit 2022, më pas sulme kibernetike në platformat e informacionit të qeverisë malazeze online, në gusht 2022 që vendosën infrastrukturën thelbësore (si atë bankar, sistemet e ujit dhe energjisë elektrike) në rrezik të lartë dhe disa ngjarje të ngjashme në Maqedoninë e Veriut (sulme keqdashëse DoS "ndërprerja e shërbimeve të distribuimit") në faqen e Komisionit Shtetëror Zgjedhor gjatë zgjedhjeve të korrikut 2020, kërcënime me email për pajisje bombarduese të vendosura në 876 institucione arsimore dhe 42 institucione të tjera gjatë periudhës tetor 2022 – Mars 2023 dhe sulme keqdashëse kibernetike ransomware ndaj institucioneve qeveritare si Fondi i Sigurimeve Shëndetësore në shkurt 2023.¹ Rajoni i Ballkanit Perëndimor përballlet me sfida të ndryshme në mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e infrastrukturës së

tij kritike, duke përfshirë energjinë, transportin, sistemet bankare, shëndetin, furnizimin me ujë, prodhimin e ushqimit dhe infrastrukturën digjitale.

Duke marrë parasysh kontekstin aktual gjeopolitik dhe të sigurisë në rajonin më të

gjerë ka një rritje të vazhdueshme të sulmeve kibernetike në rajon, për faktin se disa vende të rajonit janë shtete anëtare të NATO-s si Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, andaj ka një nevojë të madhe për zbatimin e veprimeve dhe masave adekuate për të ndërtuar qëndrueshmëri.

Llojet kryesore të Infrastrukturës Kritike në vendet e Ballkanit Perëndimor

Infrastruktura kritike luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin social të rajonit. Megjithatë, mirëmbajtja e dobët dhe masat e papërshtatshme të mbrojtjes e bëjnë infrastrukturën të ndjeshme ndaj rreziqeve të mundshme. Është e rëndësishme të theksohet se qasjet e vjetruara të mbrojtjes dhe mungesa e koordinimit ndërmjet sistemeve të ndryshme, e bën gatishmërinë për krizat e reja të jetë joadekuate. Duhet të theksojmë gjithashtu qasjet e vjetruara të mbrojtjes dhe mungesën e koordinimit ndërmjet sistemeve të ndryshme bën gatishmërinë për krizat e reja jo të mjaftueshme. Infrastruktura kritike kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin ekonomik të vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke u mundësuar bizneseve të operojnë në mënyrë efektive, duke siguruar gjithashtu stabilitet social dhe duke ofruar shërbime bazë në të cilat mbështeten qytetarët. Llojet kryesore të infrastrukturës kritike në Ballkanin Perëndimor janë:

- Infrastruktura e energjisë (prodhimi, transmissioni dhe shpërndarja e energjisë elektrike) është thelbësore për furnizimin me energji të ekonomive familjare, bizneseve dhe industrive. Gjithashtu mbështet zhvillimin e burimeve të rinovueshme të energjisë që mund të zvogëlojnë varësinë nga lëndët djegëse fosile.
- Infrastruktura e transportit (rrugët, hekurudhat, aeroportet dhe portet) është thelbësore për lidhjen e njerëzve dhe mallrave në të gjithë rajonin. Lehtëson tregtinë dhe turizmin duke mbështetur gjithashtu përpjekjet e reagimit ndaj emergjencave.
- Infrastruktura e telekomunikacionit (rrjetet e internetit, rrjetet e telefonisë celulare dhe sistemet e transmetimit) është jetike për komunikimin ndërmjet individëve, si dhe ndërmjet bizneseve dhe qeverive. Gjithashtu mbështet tregtinë elektronike dhe shërbimet digjitale që mund të nxisin rritjen ekonomike.
- Infrastruktura e ujit dhe kanalizimeve (impianetet e trajtimit të ujit, sistemet e ujërave të zeza dhe rrjetet e ujitjes) është e nevojshme për ofrimin e ujit të pijshëm të pastër për qytetarët duke menaxhuar gjithashtu ujërat e zeza në mënyrë të sigurt.
- Infrastruktura e kujdesit shëndetësor (spitalet, klinikat, laboratorët dhe zinxhirët e furnizimit mjekësor) është kritike për ofrimin e kujdesit mjekësor për qytetarët gjatë emergjencave, si dhe gjatë nevojave rutinë shëndetësore.
- Infrastruktura e shërbimeve të emergjencës (stacionet e policisë, zjarrfikësit, agjencitë e mbrojtjes civile) është thelbësore për t'iu përgjigjur situatave të fatkeqësive natyrore ose krizave të shkaktuara nga njeriu.

Tabela 1: Sektorët dhe nën-sektorët te Infrastrukturës Kritike të identifikuar në Vendet e Ballkanit Perëndimor**Vendet e Ballkanit Perëndimor**

Kosova	<p>Mallrat e rrezikshme (prodhimi dhe ruajtja, përpunimi i materialeve kimike, biologjike radiologjike dhe bërthamore);</p> <p>Energjia Energjia (prodhimi, transmissioni, shpërndarja, ruajtja);</p> <p>Shërbimet financiare (sistemet bankare, bursa, sistemet e pagesave dhe sigurimit);</p> <p>Ushqimi dhe bujqësia (prodhimit, përpunimi, ruajtja);</p> <p>Objektet dhe hapësirat qeveritare;</p> <p>Kujdesi shëndetësor dhe shëndeti publik (shëndetësia, prodhimi i produkteve mjekësore);</p> <p>Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (electronic communication, video and audio broadcasting, information systems, telecommunication, data transmission);</p> <p>Vlerat kombëtare;</p> <p>Shërbimet publike (shërbimet emergjente, mbrojtja dhe shpëtimi, shërbimet e administratës civile, funksionet qeveritare, shërbimet postare dhe korrier, rendi publik, drejtësia dhe shërbimi korrektues, forcat e armatosura);</p> <p>Transporti (rrugor, hekurudhor, ajror); dhe</p> <p>Furnizimi me ujë dhe ujërat e zeza (furnizimi, rezervuarët dhe digat).</p>
Shqipëria	<p>Prodhimi i energjisë elektrike, me sistemet e transmissionit dhe shpërndarjes; prodhimi, rafinimi, trajtimi, ruajtja dhe shpërndarja e gazit përmes tubacioneve; nafta dhe prodhimi i produkteve të saj, ruajtja dhe shpërndarja nëpërmjet tubacioneve;</p> <p>Telekomunikacioni (rrjetet, sistemet);</p> <p>Furnizim me ujë;</p> <p>Bujqësia, prodhimi dhe shpërndarja e ushqimit;</p> <p>Shëndeti publik (hospitals, health centers and ambulances);</p> <p>Sistemet e transportit (furnizimi me karburant, rrjeti hekurudhor, aeroportet, portet, transporti i brendshëm);</p> <p>Shërbimet financiare (bankare, klering);</p> <p>Shërbimet e sigurisë dhe mbrojtjes.</p>

Maqedonia e Veriut	<p>Energjia (prodhimi, duke përfshirë digat, minierat, transmetimin, ruajtja, transporti i energjisë dhe energjisë, shpërndarja, etj.);</p> <p>Transporti (komunikacioni rrugor, hekurudhor, ajror dhe ujor);</p> <p>Sistemet bankare dhe infrastruktura e tregjeve financiare;</p> <p>Shëndetësia (kujdesi shëndetësor, prodhimi, tregtia dhe kontrolli i barnave);</p> <p>Furnizimi me ujë (sistemet e furnizimit me ujë dhe kullimit);</p> <p>Ushqimi (prodhimi dhe furnizimi me ushqime, rezervat ushqimore);</p> <p>Prodhimi, ruajtja dhe transportimi i substancave të rrezikshme (materiale kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore);</p> <p>Shërbimet publike (ruajtja e rendit dhe qetësisë publike, mbrojtja dhe shpëtimi, ndihma mjekësore emergjente) dhe</p> <p>Infrastruktura digjitale, teknologjitë e komunikimit dhe informacionit (komunikimet elektronike, transmetimi i të dhënave, pajisjet dhe instalimet e informacionit, shërbimet e mediave audio dhe audiovizive, etj.).</p>
Serbia	<p>Energjia;</p> <p>komunikacioni;</p> <p>Furnizimi me ujë dhe ushqim;</p> <p>Kujdesi shëndetësor;</p> <p>Financat;</p> <p>Teknologjia e telekomunikacionit dhe informacionit;</p> <p>Mbrojtja e mjedisit dhe funksionimi i organeve shtetërore.</p>
Mali i Zi	<p>Energjia; Transporti;</p> <p>Furnizim me ujë;</p> <p>Shëndeti,</p> <p>Financa;</p> <p>Komunikimet elektronike</p> <p>Teknologjia e informacionit dhe komunikimit;</p> <p>mbrojtjen e mjedisit;</p> <p>Funksionimi i organeve shtetërore dhe</p> <p>Fusha të tjera me interes publik.</p>

- Bosnja dhe Hercegovina**
- Industria, energjia dhe minierat** (burimet hyrëse, objektet, sistemet e transmisionit, ruajtja, transporti i produkteve, energjia, sistemet e shpërndarjes);
 - Infrastruktura e informacionit dhe e komunikimit** komunikimet elektronike, transmetimi i të dhënave, sistemet e informacionit, ofrimi i shërbimeve të mediave audio dhe audiovizuale);
 - Komunikacioni** (komunikacioni rrugor, hekurudhor dhe ajror dhe trafiku ujor i brendshëm);
 - Kujdesi shëndetësor** (kujdesi shëndetësor, prodhimi, transporti dhe mbikëqyrja e barnave);
 - Aktivitetet komunale, objektet e infrastrukturës komunale**, (veçanërisht në fushën e prodhimit dhe ofrimit të trajtimit të ujit, trajtimit dhe largimit të ujërave të zeza, prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë termike, largimit të mbeturinave nga objektet rezidenciale dhe biznesore);
 - Menaxhimi i ujit** (objektet rregullatore dhe mbrojtëse të menaxhimit të ujit);
 - Ushqimi dhe pijet** (prodhimi dhe furnizimi i ushqimeve dhe pijeve, sistemi i sigurisë së ushqimit dhe pijeve, inventarët);
 - Financa** (bankare, bursa, investimet, sistemet e pagesave dhe sigurimit);
 - Prodhimi, magazinimi dhe transporti i materialeve të rrezikshme** (materiale kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore);
 - Shërbimet Publike;**
 - Arsimi;**
 - pasuritë kulturore dhe natyrore;**

Korniza e politikave të Mbrojtjes së Infrastrukturës Kritike (Strategjitë dhe Praktikat) në Ballkanin Perëndimor dhe përafrimi me BE-në

Baza e legjislacionit për mbrojtjen e infrastrukturës kritike në Bashkimin Evropian (BE) mund të gjendet në politikat të luftës kundër terrorizmit, siç është komunikata e lëshuar nga Komisioni Evropian në vitin 2004, pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Komunikata e Komisionit Evropian për Mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike në Luftën kundër Terrorizmit, përshkruan rekomandimet se si të përmirësohet parandalimi, gatishmëria dhe reagimi evropian ndaj sulmeve terroriste që përfshijnë Infrastrukturat Kritike. Në vitin 2006, Komisioni Evropian publikoi Programin Evropian për Mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike. Objektivi i përgjithshëm i këtij programi është të përmirësojë mbrojtjen e infrastrukturave kritike në BE, gjë që do të arrihet me krijimin e një kuadri të BE-së në lidhje me mbrojtjen e infrastrukturës kritike të përcaktuar në këtë komunikatë.

Plani i Veprimit të këtij programi organizon aktivitetet e Mbrojtjes së Infrastrukturës Kritike rreth tre shtigjeve të punës. (i) Meqë Shtegu i Punës 1 fokusohet në aspektet strategjike të Programit Evropian për Mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike dhe zhvillimin e masave që mund të zbatohen horizontalisht në të gjithë punën e mbrojtjes së infrastrukturës kritike; (ii) Shtegu i Punës 2 i kushtohet mbrojtjes së Infrastrukturave Kritike Evropiane në nivel sektori. Përfshin masa dhe veprime specifike të përshtatura për sektorë të ndryshëm për të siguruar qëndrueshmërinë e Infrastrukturave Kritike në të gjithë Evropën; (iii) Shtegu i Punës² ofron mbështetje për Shtetet Anëtare në përpjekjet e tyre për të mbrojtur Infrastrukturën e tyre Kritike Kombëtare. Ky shteg fokusohet në ofrimin e asistencës vendeve individuale në zhvillimin dhe zbatimin e strategjive efektive të Mbrojtjes së Infrastrukturës për infrastrukturat e tyre kritike.³ Në vitin 2008 u miratua Direktiva e Këshillit të BE-së 2008/114/EC. Kjo direktivë

vendosi një procedurë për identifikimin dhe përcaktimin e infrastrukturave kritike evropiane dhe qasje të përbashkët për vlerësimin e nevojës për të përmirësuar mbrojtjen e këtyre infrastrukturave.⁴ Kjo direktivë është në fuqi nga 12 janari 2009 deri më 17 tetor 2024, dhe duhet të ishte zbatuar në rregulloren kombëtare më së voni deri më 12 janar 2011.

Gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor janë në procesin e anëtarësimit për t'u bërë anëtarë të BE-së, dhe në kuadër të këtij procesi, ato kanë detyrime kontraktuale për të e zhvendosur në legjislacionin e tyre kombëtar Acquis të BE-së dhe standarde të tjera si pjesë e Marrëveshjeve të Stabilizim Asociimit (MSA). Prandaj sipas kësaj, në vitin 2018 Komisioni Evropian dhe përfaqësuesit e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor nënshkruan një Plan të Përbashkët për Luftë Kundër Terrorizmit për Ballkanin Perëndimor,⁵ i cili përfshin veprime përkatëse rajonale dhe kombëtare në lidhje me infrastrukturën kritike, si p.sh., përmirësimi i mbrojtjes së Infrastrukturës Kritike, mbrojtjen e përmirësuar të hapësirës kibernetike dhe ftesa e vazhdueshme e përfaqësuesve nga gjashtë ekonomitë për të qenë pjesë e dimensionit të jashtëm të Programit Evropian për Mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike, dhe projekteve të tij si dhe aktiviteteve të zhvillimit të kapaciteteve për mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike.

Qeveritë e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor përdorin përkufizime të ndryshme të Infrastrukturës Kritike. Sipas Ligjit për Infrastrukturën Kritike të vitit 2018, Kosova e përkufizon Infrastrukturën Kritike si: "Sistemet dhe asetet, qofshin ato fizike apo virtuale, janë aq jetike për Republikën e Kosovës saqë ndërprerja, paaftësia ose shkatërrimi i sistemeve dhe asetëve të tilla do të kishte një ndikim dobësues në sigurinë, ekonominë, shëndetin publik ose ndonjë kombinim të tyre".⁶

Nga ana tjetër, Ligji i Shqipërisë për Mbrojtjen Civile 7 e përcakton Infrastrukturën Kritike si: "Strukturat fizike, rrjetet dhe asetet e tjera të nevojshme për funksionimin ekonomik dhe social të një shoqërie ose komuniteti". Maqedonia e Veriut ka një përkufizim më të gjerë të Infrastrukturës Kritike si: "Pasuritë fizike ose virtuale, sistemet, objektet, rrjetet ose pjesët e tyre që kryejnë funksione jetësore të shoqërisë dhe që janë të një rëndësie thelbësore si dhe ndërprerja e punës së tyre ose shkatërrimi i tyre do të kishte një ndikim të rëndësishëm ose pasoja të rënda për sigurinë kombëtare, shëndetin dhe jetën e njerëzve, mjedisin, sigurinë e qytetarëve, stabilitetin ekonomik, pra në përgjithësi funksionimin e shtetit".⁷

Për të ndërtuar qëndrueshmëri të Infrastrukturës Kritike, një aspekt tjetër që duhet marrë parasysh është edhe kategorizimi i tij. Një kategorizim i tillë në sektorë dhe nënsektorë bëhet sipas Direktivës së BE-së 20202 për Qëndrueshmërinë e Subjekteve Kritike. Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë identifikuar sektorë të ndryshëm të Infrastrukturës Kritike dhe nën-sektorë përkatës. Kjo bëhet përmes qasjeve të ndryshme nga vendet e Ballkanit Perëndimor, kryesisht duke ndjekur qasjen e BE-së, por edhe duke marrë parasysh kontekstet dhe prioritetet kombëtare.

Shqipëria ka identifikuar grupin e mëposhtëm të sektorëve dhe nënsektorëve të Infrastrukturës Kritike, sipas Ligjit 45/2019 për Mbrojtjen Civile, siç tregohet në tabelën e mësipërme. Vlen të theksohet se si Kosova ashtu edhe Shqipëria kanë identifikuar të njëjtët sektorë të Infrastrukturës Kritike si energjia, telekomunikacioni, furnizimi me ujë, bujqësia, shëndeti publik, sistemet e transportit dhe shërbimet financiare. Nga ana tjetër, ka sektorë të veçantë unikë për secilin vend. Sektorët unikë të Infrastrukturës Kritike për Kosovën (në krahasim me atë të Shqipërisë) janë mallra të rrezikshme, vlera kombëtare dhe sektorët publikë. Sektorët unikë të Infrastrukturës Kritike për Shqipërinë (krahasuar me atë të Kosovës) janë prodhimi i energjisë elektrike (sistemet e transmissioinit dhe shpërndarjes), prodhimi, rafinimi, trajtimi, ruajtja dhe shpërndarja e gazit përmes tubacioneve, nafta (dhe prodhimi produktet të saj, magazinimi, dhe shpërndarjen nëpërmjet

tubacioneve), shërbimet e sigurisë dhe mbrojtjes.

Kur krahasojmë Infrastrukturën Kritike të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, mund të vërejmë se të dy vendet ndajnë sektorë të ngjashëm të Infrastrukturave Kritike si energjinë, transportin dhe shërbimet publike. Përderisa Kosova thekson mbrojtjen e vlerave kombëtare në infrastrukturën e saj kritike, Maqedonia e Veriut i kushton rëndësi të madhe sistemeve të saja bankare dhe infrastrukturës së tregjeve financiare. Infrastruktura Kritike e Kosovës përfshin sektorë si teknologjia e informacionit dhe komunikimit, uji dhe ujërat e zeza, ndërsa ajo e Maqedonisë së Veriut përfshin aspekte si shëndeti dhe prodhimi i ushqimit.

Analiza e ligjeve të shteteve përkatëse të Mbrojtjes së Infrastrukturës Kritike në Ballkanin Perëndimor tregon se janë miratuar katër ligje specifike për vendosjen e sistemeve të Infrastrukturës Kritike dhe transpozimi e pjesëve të Direktivës së BE-së 2008/14/EC. Ligjet i kanë miratuar Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia. Maqedonia e Veriut ka hartuar Ligjin për Infrastrukturën Kritike, 2022.⁸

Republika e Kosovës, në vitin 2018 ka miratuar "Ligjin për Infrastrukturën Kritike" (më shumë për këtë ligj në vijim). Shqipëria, në vitin 2019 ka miratuar "Ligjin për Mbrojtjen Civile". Mali i Zi, në vitin 2019 miratoi "Ligjin për Përcaktimin dhe Mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike". Serbia, në vitin 2018 ka miratuar "Ligjin për Infrastrukturën Kritike". Bosnja dhe Hercegovina miratoi "Ligjin për Sigurinë e Infrastrukturës Kritike". Maqedonia e Veriut, në vitin 2022 ka miratuar Ligjin për Infrastrukturën Kritike. Mbrojtja e Infrastrukturës Kritike në Ballkanin Perëndimor është një rrugëtim i gjatë, por janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për hartimin e këtyre ligjeve sipas udhëzimeve të BE-së. Në këto shtete pas miratimit të ligjit, u caktuan edhe grupe pune për të udhëhequr zbatimin e ligjit. Bazuar në të lart cekurat mund të konkludojmë se ekziston një vullnet i mirë për të krijuar një sistem efikas të Infrastrukturës Kritike në Ballkanin Perëndimor. Ky regjion ka nevojë për bashkëpunim politik dhe profesional për të harmonizuar metodologjitë për mbrojtjen e infrastrukturës kritike.⁹

Sugjerime për qëndrueshmërinë e infrastrukturës kritike në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor

Duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të çdo vendi, është thelbësore që rekomandimet të përshtaten sipas kontekstit dhe kërkesave specifike të secilit vend. Një strategji e integruar që përfshin zgjidhjet teknologjike, formulimin e politikave dhe përfshirjen e komunitetit do të jetë vendimtare për forcimin e qëndrueshmërisë

së infrastrukturës kritike në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Për t'u siguruar që infrastruktura kritike në Kosovë dhe në vendet e Ballkanit Perëndimor mund të i kapërcejnë sfidat, dhe duke marrë parasysh atë që kemi diskutuar më lart, ne do i paraqesim disa rekomandime siç vijojnë më poshtë:

- Përafrimi i përkufizimeve dhe kategorizimet e infrastrukturës kritike në vendet e Ballkanit Perëndimor për të siguruar konsistencë në kuptimin dhe zbatimin e masave mbrojtëse.
- Lehtësimi i bashkëpunimit rajonal dhe mekanizmave të shkëmbimit të informacionit midis vendeve të Ballkanit Perëndimor për të përmirësuar përgjigjet e koordinuara ndaj kërcënimeve ndërkufitare, të tilla si sulmet kibernetike dhe fatkeqësitë natyrore.
- Zhvillimi dhe zbatimi i strategjive për të mbrojtur qëndrueshmërinë e infrastrukturës kritike ndaj fatkeqësive natyrore duke integruar elementet e ndryshimeve klimatike në kornizat e mbrojtjes.
- Inkurajimi i bashkëpunimit ndërmjet sektorëve publikë dhe privatë në vendet e Ballkanit Perëndimor për të rritur mbrojtjen e infrastrukturës kritike, duke shfrytëzuar burimet, ekspertizën dhe përparimet teknologjike.
- Investimi në programe trajnimi dhe iniciativa për ndërtimin e kapaciteteve për profesionistët përkatës, duke përfshirë zbatimin e ligjit, reaguesit e emergjencës dhe ekspertët e sigurisë kibernetike, për të forcuar efektivitetin e përgjithshëm të përpjekjeve për mbrojtjen e infrastrukturës kritike.
- Përafrimi i vazhdueshëm me praktikën e mbrojtjes së infrastrukturës kritike në Ballkanin Perëndimor me standardet dhe praktikën më të mira të BE-së, duke shfrytëzuar Planin e Përbashkët të Veprimit për Luftë Kundër Terrorizmit.

Referenca

1. Popovski, V. Parandalimi i krizës dhe infra-struktura kritike në Ballkanin Perëndimor, 2023, <https://idsocs.org.mk/wp-content/uploads/2023/05/Second-Paper-Online.pdf>
2. EU Monitor, <https://www.eumonitor.eu/9353000/1/19vvik7m1c3gyxp/vhcrn058d-nzv>
3. EUR Lex, Qasja në Ligjin e Bashkimit Evropian, 2006, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A52006DC0786>
4. Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, Direktiva e Këshillit 2008/114/EC, 2008, <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2008:345:0075:0082:en:PDF#:~:text=This%20Directive%20establishes%20a%20procedure.to%20the%20protection%20of%20people>
5. Punët e Brendshme-KE-Evropë, Plani i Përbashkët i Veprimit për Luftë Kundër Terrorizmit për Ballkanin Perëndimor, 2018, https://home-affairs.ec.europa.eu/system/files/2018-10/20181005_joint-action-plan-counter-terrorism-western-balkans.pdf
6. Migrimi dhe punët e brendshme, BE, https://home-affairs.ec.europa.eu/pages/page/critical-infrastructure_en
7. Ligji 45/2019 për Mbrojtjen Civile, <https://qbz.gov.al/eli/ligji/2019/07/18/45>
8. Projektligji për infrastrukturën kritike - Versioni dhjetor, https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=77229
9. Vështrime mbi zhvillimin rajonal, 2022, [http://doi.org/10.9770/IRD.2022.4.2\(5\)](http://doi.org/10.9770/IRD.2022.4.2(5))

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

338.49(497)(047)

Limaj, Jon

Perspektiva rajonale : si qëndrojnë vendet e Ballkanit Perëndimor
në mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike? / Jon Limaj. – Prishtinë : QKSS,
2023. – 9 f. ; 28 cm.

ISBN 978-9951-842-13-6

Rreth QKSS

E themeluar në prill të vitit 2008, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) është një organizatë e specializuar dhe e pavarur joqeveritare. Qëllimi primar i QKSS është të promovojë demokratizimin e sektorit të sigurisë në Kosovë dhe të përmirësojë punën kërkimore dhe avokuese në lidhje me sigurinë, sundimin e ligjit dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e sigurisë.

QKSS synon të rrisë efektivitetin e Reformës së Sektorit të Sigurisë duke mbështetur programet e këtij sektori përmes hulumtimeve, eventeve, trajnimeve, avokimit dhe këshillave të drejtpërdrejta për politikë-bërësit.

Avancimi i ideve të reja dhe metodave të shkencave sociale janë gjithashtu vlerat thelbësore të qendrës. Çdo vit, QKSS publikon raporte të shumta, analiza të politikave dhe përmbledhje të politikave për çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë. QKSS gjithashtu organizon më shumë se 200 ngjarje publike duke përfshirë konferenca, tryeza dhe debate, ligjërata në Kosovë, ku një pjesë e tyre organizohen në bashkëpunim me partnerë rajonalë dhe ndërkombëtarë.

Një gamë e gjerë aktivitetesh përfshijnë hulumtimin, ngritjen e kapaciteteve, ngritjen e ndërgjegjësimit dhe avokimin. Puna e QKSS-së mbulon një gamë të gjerë temash, duke përfshirë por pa u kufizuar në: reformën dhe zhvillimin e sektorit të sigurisë, identifikimin dhe analizimin e rreziqeve të sigurisë që lidhen me ekstremizmin, radikalizmin dhe krimin e organizuar, politikën e jashtme dhe bashkëpunimi rajonal, dhe vlerësimin e sundimit të ligjit në Kosovë. Këtë vit QKSS shënoi 15 vjetorin e themelimit. Për më tepër detaje rreth QKSS, mund të referoheni tek:



qkss.org
securitybarometer.qkss.org



@KCSSQKSS
#KCSSQKSS

ISBN 978-9951-842-13-6



9 789951 842136